



SHPALLJE PËR TENDER PUBLIK

ID iProkurimit:	FSDK14 004 231
Data e publikimit:	8.09.2014
Data e mbylljes:	2.10.2014në ora 14:00
Data e hapjes publike të ofertave:	2.10.2014 në ora 14:30
Objekti i kontratës:	Auditimi i Jashtëm i pasqyrave financiare të Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës për vitet financiare 2014-2016
Autoriteti kontraktues:	Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës(FSDK)
Adresa:	Rr. Pashko Vasa, pn, Kati i I-rë, “ Qyteza Pejton” 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefoni:	+381 38 610 355 ; + 381 38 610 356 ;
Fax:	+ 381 38 610 357
E-mail:	procurement@fsdk.org

1. DEKLARATËPËRMBLEDHËSE

Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës (më poshtë i referuar si "FSDK") është duke kërkuar një firmë të pavarur të auditimit të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht për ofrimin e shërbimeve të auditimit të jashtëm. Në bazë të nenit 28.5 të Ligjit Nr.03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhe të ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-216 mbi llogaritë, të dhënat dhe deklaratat financiare të FSDK do të auditohen nga një auditor i jashtëm i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht, i cili është i miratuar nga Bordi Drejtues.

1.1. Korniza e raportimit financiar

FSDK si kornizë të saj të raportimit për pasqyrat vjetore financiare zbaton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), duke përfshirë interpretimet, rekomandimet dhe udhëzimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2. FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMEVE

Kompania e auditimit do të kryejë auditimin e pasqyrave financiare vjetore të FSDK-së për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2014, dhe vitet e mëvonshme financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 dhe 2016.

Auditimi i jashtëm do të ndërmarrë ekzaminimin e evidencës nga pasqyrat financiare (pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e pozitës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në bilancin e fondeve, pasqyrën e rrjedhës sëparasë dhe të shpalosjeve përcjellëse) që janë përgatitur në përputhje me standardet kontabilitetit dhe të raportimit SNK dhe SNRF, në mënyrë që të konstatohet se a paraqesin paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materialetransaksionettë përmbledhura për periudhëne raportimit financiar nga janari 2014 deri në 31 dhjetor 2014, dhe vitet e mëvonshme financiare në vitin 2015 dhe 2016.

3. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Kontrata do t'i jepet ofertuesit me ofertën **ekonomikisht më të favorshme** dhe teknikisht të pranueshme siç përcaktohet me kriteret e peshuara si më poshtë.

3.1. Vlerësimi teknik

Komisioni i vlerësimit, do të vlerësojë ofertat teknike në bazë të përgjegjësisë së tyre ndaj Termave të Referencës, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret dhe sistemin e pikëve të specifikuar mëposhtë:

Kriteri i vlerësimit	Pikët
Plani i Menaxhimit: Përvoja specifike e ofertuesit lidhur me punën	30
• Përvoja teknike si auditor ndërkombëtar (15 pikë)	
• Përvojë të mëparshme auditimi në sektorin financiar (10 pikë)	
• Përvoja regjionale e ofertuesit (5 pikë)	
Plani i Burimeve: Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesor të propozuar	30
• udhëheqësi ekipit (10 pikë)	
• auditorë profesional (20 pikë)	
Metodologjia e propozuar: Përshtatshmëria e planit të propozuar të punës dhe metodologjisë dhe përgjegjshmëria ndaj Termave të Referencës së Dosjes së ofertës	40
Gjithsej	100

Rezultati minimal teknik është 60 pikë. Çdo ofertë do të refuzohet në këtë fazë nëse ajo dështon ta arrijë rezultatin minimal teknik prej 60 pikëve.

3.2. Vlerësimi Financiar

Ofertës më të ulët financiare do të jepet një rezultat financiar (OUF) prej 100pika. Rezultatet financiare (RF) të ofertuesve tjerë do të llogariten si më poshtë: $FS = 100 * OUF / F$, ku F është çmimi i ofertës në shqyrtim.

3.3. Vlerësimi i agregatit përfundimtar

Ofertat do të renditen në bazë të rezultateve të tyre të kombinuara, teknike dhe financiare (rezultati i kombinuar) në bazë të formulës në vijim (50% peshim nga rezultati teknik dhe 50% peshim nga rezultati financiar): rezultati i kombinuar i secilit ofertues = $50\% * \text{rezultati teknik} + 50\% \text{ rezultati financiar}$.

4. KUSHTET E OFERTËS DHE KUSHTET PËR PJESMARRJE

- Ofertuesit duhet të kërkojë dosjen e ofertës që mund të merret nga procurement@fsdk.org
- Nga ofertuesit pritet që t'i shqyrtojnë me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosje për oferta dhe shtojcat e saj dhe t'i përmbushin të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e dhëna aty.